Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qendrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3 , Tiranë (Ish-Hotel Dajti), deri më datë 29 Prill 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT  
POPULLOR****Njoftim për vend të lirë pune**

TKOBAP, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së, shpall 1 (një) vend vakant në pozicionin e punës Drejtor pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në nivelin Master në degën Financë/Kontabilitet
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet (preferohet në sektorin publik)
3. Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet kompjuterike dhe ato financiare
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur
5. Të ketë aftësi të organizojë punën në ngarkim me efikasitet, efektivitet dhe sipas afateve të përcaktuara
6. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike
7. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Përgjegjësitë/Detyrat kryesore të Drejtorit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

1. Drejton punën në lidhje me detyrat ekonomike financiare të institucionit nëpërmjet ndjekjes me efikasitet, efektivitet dhe transparencë të financave publike.
2. Administron dhe kontrollon veprimtarinë prodhuese, menaxhimin dhe ruajtjen e vlerave materiale e monetare të institucionit.
3. Ndjek dhe monitoron në vijim punën zbatimin e kontratave të lidhura, realizimin e shërbimeve dhe furnizimin e institucionit me bazë materiale.
4. Kontrollon buxhetin e institucionit, koordinon punën dhe zbaton politikën për të ardhurat në bazë të legjislativës në fuqi.
5. Organizon dhe ndjek zhvillimin e punës së stafit nën varësi në bazë të platformës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka përgjegjësi për monitorimin dhe raportimin e punës së tyre.
6. Ka përgjegjësi për promovimin dhe zhvillimin e duhur të imazhit të institucionit.

7. Mban përgjegjësi për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave në zbatim të objektivave të drejtorisë që përfaqëson dhe porosive të titullarit të institucionit.
8. Ka përgjegjësi për ndjekjen dhe mirëadministrimin e burimeve njerëzore të institucionit.
9. Mbikëqyr dhe ndjek përmbushjen e punës nga ana e përgjegjësve dhe specialistëve të drejtorisë si dhe bashkërendon dhe koordinon punët me drejtoritë dhe sektorët e tjerë në realizimin detyrave në bazë të platformës institucionale të Drejtorit të Përgjithshëm.
10. Kontrollon zbatimin e shpenzimeve dhe informon periodikisht Drejtorin e Përgjithshëm për gjendjen financiare të institucionit.
11. Drejton, kontrollon dhe administron arkëtimin e të ardhurave në lekë dhe valutë të cilat rezultojnë nga veprimtaria e institucionit.
12. Drejton inventarin fizik dhe kontabël të institucionit duke bërë rakordimet përkatëse.
13. Realizon kontroll të brendshëm në lidhje me sektorët e prodhimit dhe të shpenzimeve.
14. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për nevoja të institucionit kryen edhe detyra të tjera brenda kushteve thelbësore të kontratës së punës.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;

\*Dokumentet duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së deri në datën 4.5.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës Drejtor pranë DFSHM.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë.

## **INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

**Njoftim për vend të lirë pune**

Instituti i Shëndetit Publik shpall pozicionin e punës si vijon:

- Specialist, Drejtoria e Mbrojtjes nga Rrezatimet (1 Vend Pune)

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

Vlerësimi për trajtimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë sipas rregullores Nr. 638, datë 7.9.2016 “PËR TRAJTIMIN E SIGURT TË MBETJEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, e cila përfshin:

Zbatimin e rregullores për trajtimin e mbetjeve radioaktive, mënyrën e zbatimit të Programit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve Radioaktive, Inventarin e të gjitha mbetjeve radioaktive, vlerësimin për Programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive.

Sistemet e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, Trajnimi, Sigurimin, vlerësimin e sigurisë, përgatitja dhe reagimi në raste emergjence, transporti i mbetjeve radioaktive, Menaxhimi i mbetjeve radioaktive, Financimi i menaxhimit të mbetjeve radioaktive, Minimizimi i prodhimit të mbetjeve radioaktive, Ripërdorimi dhe riciklimi i burimeve që nuk përdoren, Shkarkimi i mbetjeve radioaktive, Klasifikimi i mbetjeve radioaktive, Trajtimi dhe kondicionimi, Paketimi, Kushtet e përgjithshme për ruajtjen e përkohshme, Licencimi i subjekteve, Nivelet e pranimit të mbetjeve, mbajtja e regjistrit të mbetjeve radiaktive.

Në zbatim të VKM Nr.158, datë 13/02/2008 “Për Import -Eksportin e Burimeve të Rrezatimeve Jonizues në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar Specialisti jep mbështetje për import eksportet dhe transportet e materialeve dhe burimeve të rrezatimit jonizues

Në zbatim të rregullores Nr.743, datë 16.10.2012 “PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA RREZATIMET JOJONIZUESE” i ndryshuar specialisti jep mbështetje për vlerësimet në lidhje me burimet e rrezatimit jojonizues.

Kandidati për vendin e punës “Specialist, Drejtoria e Mbrojtjes nga Rrezatimet” duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të zotërojë Diplomë të nivelit Master Shkencor në degën Fizikë / Kimi / Inxhinieri Telekomunikacioni, gjithashtu dhe Diploma e nivelit të parë të jetë në të njëjtën degë;
2. Të ketë notë mesatare universitare mbi 7;
3. Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze me dëshmi;
4. Të ketë njohuri të mira kompjuterike;
5. Të njohë legjislacionin e mbrojtjes nga rrezatimet në Republikën e Shqipërisë;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
7. Të ketë aftësi komunikuese dhe të punuarit në grup;

Kandidatët aplikantë për vendin e punës kërkohet të plotësojnë edhe këto kritere preferenciale:

1. Të ketë njohuri në dozimetritë e rrezatimeve jonizuese dhe llogaritje në mbrojtjen nga rrezatimet;
2. Të ketë njohuri mbi çështjet që lidhen me trajtimin dhe menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive;
3. Të ketë njohuri në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë, do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- Motivimin në punë, personalitetin, njohjen e gjuhëve të huaja, aftësinë komunikuese;

Mënyra e vlerësimit:

Kandidatët do të vlerësohen bazuar në Urdhërin Nr.511, datë 13.12 2011 “Për kriteret e Punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik” të Ministrisë së Shëndetësisë.



Përcaktimet vlerësuese:

Nota mesatare

Mbi 9 vlerësohet me 15 pikë

Mbi 8 vlerësohet me 12 pikë

Mbi 7 vlerësohet me 8 pikë

Mbi 6 vlerësohet me 4 pikë

Mbi 5 vlerësohet me 2 pikë

Grada apo titulli shkencor/specializim vlerësohet me 20 pikë

Gjuha e huaj e vërtetuar vlerësohet 3 pikë

Përvoja mbi 10 vjet vlerësohet 5 pikë

Intervista (maksimalisht) vlerësohet 10 pikë

✓ Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Protokollit në Institutin e Shëndetit Publik këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetë shkrimin (CV);
3. Fotokopjetë pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës, bashkë me listën e notave të noterizuara;
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Kopje e noterizuar e çertifikatë/dëshmi që vërteton njohuritë programit të paketës MicrosoftOffice;
7. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes një nga gjuhët e huaja perëndimore (Anglisht,Frëngjisht, Italisht);
8. Vërtetimi gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
9. Dëshmi Penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit,
10. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
11. Formulareve të deklaramit sipas formës së kërkuar nga ligji nr. 138/2015;
12. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
13. Vërtetim nga punëdhënësi mëparshëm (i fundit) që nuk ka masë disiplinore;
14. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet positive në punë;
15. Leja e ushtrimit të profesionit (nëse ka);
16. Certifikate familjare dhe vërtetim banimi;

Pranimi i dokumentave është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e publikimit në Buletinin e APP-së.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit të sipërcituar brenda afatit të përcaktuar në shpallje, sjell skualifikimin e kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.Për çdo paqartësi mund të dërgoni email në adresën [ishp@shendetesia.gov.al](mailto:ishp@shendetesia.gov.al).







## **TEATRI KOMBËTAR** **Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.108, dt.30.07.2015 për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës të Teatrit Kombëtar”, Kodit të Punës, të ligjit nr. 90 dt. 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, të ligjit nr. 9131, date 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të nenit 20, ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Teatrit Kombëtar, shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë, në pozicionin:

### **SPECIALIST I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MARRËDHËNIET ME JASHTË**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, si njohës i mirë i ligjeve në fushën e mediave audiovizuale dhe atë të shkruar etj. dhe kërkesat e veçanta si më poshtë :

#### **KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT**

-  Të ketë Diplomë Universitare në Degën Gazetari - Komunikim/ Marrëdhënie Ndërkombëtare/ Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.
-  Të ketë përvojë pune mbi mbi 3 vjet si gazetar/e, apo si specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë.
-  Të jetë domosdoshmërisht njohës/e i/e mirë i gjuhës angleze, por dhe gjuhëve të tjera
-  Të ketë njohuri të mira kompjuterike
-  Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.
-  Të ketë aftësi të mira komunikimi, si dhe për të punuar në grup.

Paga e pozicionit: është në kategorinë IV-a (70 000 lekë +2% të pagës së grupit për çdo vit vjetërsie).

#### **PARAQITJA E DOKUMENTAVE:**

Aplikimi fillon në datë 04.04.2024 dhe përfundon më datë 24.04.2023 ora 16.00. Tre ditë pas mbarimit të aplikimit do të bëhet shpallja e fituesit. Aplikanti do të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në Sekretarinë e Teatrit Kombëtarë adresën; Teatri Kombëtar, Rr.”Sami Frashëri” ( ArTurbina) Tiranë” cel. 042 22 89 33, (në sekretarinë e T.K) këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur
- Curriculum vitae
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi
- Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara
- Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka)
- Fotokopje të librezës së punës.
- Dëshmi të gjendjes gjyqësore.
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit
- Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave apo certifikatave.
- Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

**KONKURIMI:** Është i hapur

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të Web-it të Teatrit Kombëtar [www.teatrikombetar.gov.al](http://www.teatrikombetar.gov.al)

**SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER**  
**Njoftim për vend të lirë pune**

Drejtoria e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për pozicionet si vijon :

- Specialist , në Sektorin e Trajnimit dhe Perfomancës (një vend pune, me afat të caktuar)
- Punëtor, në Shërbimin e Laboratorit (një vend pune, pa afat të caktuar)

1. Specialist, në Sektorin e Trajnimeve dhe Perfomancës / Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier (një vend pune).

Kandidatët që konkurojnë për vendin e punës “Specialist” në Sektorin e Trajnimeve dhe Perfomancës (zëvendësues ), duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë diplomë universitare në shkencat ekonomike / juridike / natyrore ;
2. Të jenë shtetas shqitarë;
3. Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
4. Të kenë zotësi për të vepruar.””
5. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Drejtorisë në Spitalin Rajonal “Memorial” në Fier këto dokumenta :

- a. Jetëshkrimi i kandidatit ( CV) (e detyrueshme)
- b. Fotokopje e kartës së identitetit (e detyrueshme)
- c. Diploma Universitare dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse (e detyrueshme)
- d. Fotokopje e librezës së punë
- e. Dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor)
- f. Dëshmi të njohjes të gjuhëve të huaja
- g. Çertifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit
- h. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (e detyrueshme)
- i. Raport mjeko – ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës)
- j. Referenca nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka).

2. Punëtor, në Shërbimin e Laboratorëve, pranë Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, duhet të plotësojnë këto kritere:
1. Të kenë diplomë universitare në shkencat ekonomike / juridike / natyrore ;
  2. Të jenë shtetas shqitarë;
  3. Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
  4. Të kenë zotësi për të vepruar.””
  5. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Drejtorisë në Spitalin Rajonal “Memorial” në Fier këto dokumenta :

- a. Jetëshkrimi i kandidatit ( CV) (e detyrueshme)
- b. Fotokopje e kartës së identitetit (e detyrueshme)
- c. Diploma e shkollës së mesme dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse (e detyrueshme)
- d. Fotokopje e librezës së punë
- e. Dëshmi të njohjes të gjuhëve të huaja
- f. Çertifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit
- g. Formulari i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (e detyrueshme)
- h. Raport mjeko – ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës)
- i. Referenca nga punëdhënësi i mëparshëm (nëse ka).

Mosparaqitja e dokumentave ose mosparaqitja e plotë e tyre, sjell s’kualifikim të kandidatit;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat brenda 7 (shtatë) ditëve nga shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën : Spitali Rajonal “Memorial”Fier, Njoftim punësimi.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen / njoftimi i fituesit.

## **TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT** **POPULLOR**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

TKOBAP, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për

miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së, shpall 1 (një) vend vakant në pozicionin e punës Përgjegjës i Sektorit të Financës pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta në nivelin Master në degën Financë/Kontabilitet
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet (preferohet në sektorin publik)
3. Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet kompjuterike dhe ato financiare
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur
5. Të ketë aftësi të organizojë punën në ngarkim me efikasitet, efektivitet dhe sipas afateve të përcaktuara
6. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike
7. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Përgjegjësitë/Detyrat kryesore të Përgjegjës të Sektorit të Financës pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

1. Ndjek zbatimin e marrëdhënieve me thesarin, me bankat e me të tretët sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Mban dokumentacionin e plotë të veprimeve për të ardhurat dhe shpenzimet në institucion si dhe kryen rakordimet çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë për të ardhurat dhe shpenzimet.
3. Bashkërendon dhe koordinon punën e punonjësve nën varësi si dhe midis sektorit nën varësi me sektorin e shërbimeve në funksion të realizimit të qëllimit të përbashkët të punës.
4. Ndjek zbatimin e buxhetit për institucionin në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Kryen kontrole dhe inventarizime të pjesshme në arkë, magazine dhe biletari.
6. Përgatit të dhënat statistikore dhe evidencat për treguesit e punës së seksionit duke i ruajtur dhe arkivuar ato.
7. Përpilon Urdhër-Pagesat, kryen kontabilizimin e tyre dhe të ardhurave dhe plotëson e kontrollon të gjitha dokumentet shoqëruese për secilën prej tyre.
8. Kontrollon vlerat monetare që hyjnë në institucion dhe ndjek periodikisht arkëtimin e debitorëve.
9. Përpilon listëpagesat për shërbimet brenda dhe jashtë vendit.
10. Mban regjistrin e përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzime dhe investime në prokurimet me vlerë të vogël.

11. Çdo tre muaj përpilon dhe dorëzon në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit evedencat për shpenzimet, evidencat e të ardhurave dhe të qerasë.
12. Plotëson të dhënat mujore dhe progresive të analizës mujore të institucionit.
13. Merr pjesë dhe organizon inventarizimin e aseteve në fund të vitit.
14. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe për nevoja të institucionit kryen edhe detyra të tjera brenda kushteve thelbësore të kontratës së punës.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;

\*Dokumentet duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së deri në datën 4.5.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës Përgjegjës i Sektorit të Financës pranë DFSHM.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë.

## **UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në Urdhrin e Rektorit nr. 38, datë 09.04.2024, “Për miratimin e kriterëve për personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” shpall konkursin për pozicionin e punës “Personel akademik” me kohë të plotë në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Mjekësi Urgjence, Fakulteti i Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Kandidatët konkurrentë për pozicionin e punës “Personel Akademik” me kohë të plotë, 1 (një) vend në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Mjekësi Urgjence, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, duhet të plotësojnë :

## Kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i shkencave në Mjekësinë e Përgjithshme”, studime universitare brenda ose jashtë vendit me notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë).
2. Të jetë shtetas shqiptar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur.
4. Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore (Anglisht, Frëngjisht, Italisht, Gjermanisht, Spanjisht)
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të ketë lishencë për ushtrimin individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë.
7. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurren.
8. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
9. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
10. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

## Kritere specifike:

1. Të zotërojë diplomë specializimi në Mjekësinë e Urgjencës apo në specialitetet e lidhura me të (Mjekësi Interne, Anestezi -Reanimacion, Kirurgji apo ndonjë specialitet tjetër klinik, ose licensë nga Urdhri i Mjekut si Mjek Urgjence.
2. Të ketë eksperiencë pune si mjek të paktën 5 vite në Urgjencë.
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në lëndën e Mjekësisë së Urgjencës.
4. Të ketë kualifikime apo specializime ndërkombëtare në fushën e Mjekësisë së Urgjencës.

## Kritere Preferenciale:

1. Preferohen kandidatë me diplomë specializimi “Specialist Mjek Urgjence” me notë mesatare mbi 9 (nëntë).
2. Preferohen kandidatë që kanë marrë pjesë në veprimtari kërkimore dhe/ose aktivitete shkencore.
3. Preferohen kandidatë që kanë titull akademik, gradë shkencore, ose të jetë në proces doktorature.
4. Preferohen kandidatë që të kenë eksperiencë pune në struktura mjekësore universitare.
5. Preferohen kandidatë që të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.
6. Preferohen kandidatë me 2 ose me më shumë gjuhë të huaja.

## A. Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare ose të gradave dhe titujve (fotokopje të noteruara). Për diplomat master ose PhD të marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR) ose vërtetim që janë në proces njohje.
6. Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca apo seminare etj.



7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton punësimin si pedagog i jashtëm, trajnimet, arsimin shpresë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
8. Kopje e noterizuar e licencës për ushtrimin individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve;
9. Referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
10. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
11. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;
12. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj;
13. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda 3 (tre) muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
14. Vërtetim nga punëdhënësi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
15. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015;
16. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) të marrë brenda 3 (tre) muajve të fundit;

Mungesa e një prej dokumentave të kërkuara më sipër, s'jell skualifikim të kandidatit. Dokumentacioni i dorëzuar nuk mund t'ju kthehet konkurrentëve, pasi bëhet pjesë e arkivës së institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar të inventarizuar në zyrën e Protokollit të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë).

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e shpalljes në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

B. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

C. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Vlerësimi do të bëhet sipas formularit të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i publikuar në faqen zyrtare [www.umed.edu.al](http://www.umed.edu.al)

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën [info@umed.edu.al](mailto:info@umed.edu.al)



**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË****Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe në Urdhrin e Rektorit nr. 37, datë 09.04.2024, “Për miratimin e kriterëve për personel akademik në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” shpall konkursin për pozicionin e punës “Personel akademik” me kohë të plotë në Departamentin e Kirurgjisë, Lënda Urologji, Fakulteti i Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve si dhe dokumentacioni përkatës për pozicionin e punës “Personel Akademik” me kohë të plotë, 1 (një) vend, pranë Departamentit të Kirurgjisë, Lënda Urologji, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, janë si më poshtë vijon:

Kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i shkencave në Mjekësinë e Përgjithshme”, studime universitare brenda ose jashtë vendit me notë mesatare të ponderuar mbi 8 (tetë).
2. Të ketë mbaruar specializimin Kirurgji e Përgjithshme me notë mesatare mbi 9 (nëntë).
3. Të ketë eksperiencë pune si mjek Urolog.
4. Të jetë shtetas shqiptar.
5. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur.
6. Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore (Anglisht, Frëngjisht, Italisht, Gjermanisht, Spanjisht)
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
8. Të ketë lishencë për ushtrimin individual të profesionit , lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë.
9. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron.
10. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Kritere specifike:

1. Të ketë eksperiencë pedagogjike.
2. Të ketë titullin “Doktor”.
3. Të ketë punime shkencore në periodiket shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Kritere Preferenciale:

1. Preferohen kandidatë që kanë eksperiencë pune në spital universtar mbi 10 vjet.
2. Preferohen kandidatë që kanë eksperiencë pedagogjike mbi 3 vjet.
3. Preferohen kandidatë që kanë trajnime afatgjata në urologji në vendet e BE, Britani e madhe, SHBA, Japoni, Turqi.

A. Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;

2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare ose të gradave dhe titujve (fotokopje të notuara). Për diplomat master ose PhD të marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR) ose vërtetim që janë në proces njohje.
6. Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca apo seminare etj.
7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton punësimin si pedagog i jashtëm, trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
8. Kopje e noterizuar e licencës për ushtrimin individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri i Mjekëve;
9. Referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
10. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
11. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;
12. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj;
13. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda 3 (tre) muajve të fundit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
14. Vërtetim nga punëdhënësi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
15. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015;
16. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) të marrë brenda 3 (tre) muajve të fundit;

Mungesa e një prej dokumentave të kërkuara më sipër, s'jell skualifikim të kandidatit. Dokumentacioni i dorëzuar nuk mund t'ju kthehet konkurrentëve, pasi bëhet pjesë e arkivës së institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar të inventarizuar në zyrën e Protokollit të Fakultetit të Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë).

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e shpalljes në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

D. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

E. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Vlerësimi do të bëhet sipas formularit të vlerësimit të kandidatëve për personel akademik i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i publikuar në faqen zyrtare [www.umed.edu.al](http://www.umed.edu.al)

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën [info@umed.edu.al](mailto:info@umed.edu.al)

## **UNIVERSITETI I ARTEVE**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 1 (një) vënd të lirë të punës për punonjës mësimorë nga kategoria “Lektor” /“ As.Lektor” si më poshtë:

#### **I. FAKULTETI I MUZIKËS**

##### **➤ NJËSIA BAZË KANTO:**

- a. Lektor/As.Lektor për Programin e Studimit Kanto/specialiteti Kanto 1(një) punonjës mësimor

a/1. Lektor/ As.Lektor për Programin e Studimit Kanto ;

Kandidati/ët për konkursin e punonjësit mësimor për lëndën sa më lartë, duhet të plotësojnë këto kritere:

- të ketë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës / master shkencor ose master në arte (mesatarja e përgjithshme e notave mbi 9) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MARS;
- të ketë kryer Ciklin e tretë të studimeve Doktoraturë, në specialistetin përkatës (nëse ka)/fotokopje e noterizuar e Fakultetit ku ka kryer studimin brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
- të ketë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse, së paku 3 (tre) vite, brenda ose jashtë Shqipërie;
- të dëshmojë etikë të lartë profesionale dhe morale (në përputhje me KE në Uart);
- të mos ketë penalizime nga punëdhënësit e mëparshëm në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënie me kolegët;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata Brenda ose jashtë Shqipërie.

- të ketë dëshmi të njërës prej gjuhëve të huaja të BE (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht....etj.);
- të ketë 2 (dy) rekomandime nga profesionistë të shquar të fushës;
- të ketë vlerësim nga punëdhënësi i fundit. Në rastet kur kanë dhënë mësim si punonjës mësimorë me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar pranë Fak. Muzikës, Duhet të kenë vlerësim Pozitiv (nga pedagogu i lëndës ku kanë asistuar/Përgjegjësi i Njesisë Bazë), Miratuar nga Titullari i Njesisë Kryesore;
- vërtetim Mjeko Ligjor;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

- Kërkesë ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;
- Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë në profolin përkatës për arte, mesatare e përgjithshme mbi 9), ose fotokopje e noterizuar, e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
- Diplomën e Ciklit të tretë të studimeve Doktor (nëse ka) /fotokopje e noterizuar e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASR;
- Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet...etj);
- Konkurrentët duhet të jenë nën moshën 50 vjeç (përfshihen vetëm personalitetet e fushës);
- Një projekt – program për lëndën për të cilën konkurren;
- Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht)/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë shqipërie;
- Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie (3vjet) në IAL;
- Dy referenca nga profesorë/personalitetet e fushës;
- Kopje të noterizuara të kualifikimeve pasuniversitare (nëse ka);
- Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (sa më lartë)/bëjnë përjashtim kandidatët që kanë kryer studimet jashtë Shqipërie;
- Vërtetim nga qendra/t e punës së mëparshme që nuk ka penalitete në drejtim të etikës profesionale dhe marrëdhënieve me kolegët;
- Dy referenca nga personalitete të fushës
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
- Çertifikatë familjare/personale;
- Të deklarojë/dëshmojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, brenda ose jashtë Shqipërie;
- Vete-deklarim që nuk ka qenë i/e dënuar jashtë shqipërie;
- Vete-deklarim që nuk ka qenë i/e dënuar jashtë shqipërie;
- Dëshmi e gjendjes mjeksore (librezë shëndetësore).

Konkurimi për punonjës mësimorë sa më lartë do të zhvillohet në dy Faza:

(Vlerësimi maksimal 100 pikë)

- |                  |   |                                   |
|------------------|---|-----------------------------------|
| 1.1. Faza e parë | - | Shqyrtimi i dosjes së kandidatit; |
| 1.2. Faza e dytë | - | Mësim i Hapur/Koncert/Intervistë. |

Konkurrimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë”, VKM 145/10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të vecantë Uart..”, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës në RSH, Statusin dhe Statutin e Universitetit të Arteve.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data 15/04/2024 deri më datë 16/04/2024 ora 14.00.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora 08.00 deri 14.00.

## **UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik (Laborant) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Departamentin e Inxhinierisë Fizike.

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet universitare në sistemin 3+2 (Bachelor dhe Master i Shkencave) apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në Fizikë/Inxhinieri Fizike;
2. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në laborator, fizikë e përgjithshme apo laboratorë shkencorë të institucioneve të arsimit të lartë;
3. Kandidatët të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

### **II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 24.04.2024 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

## **SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS** **Njoftim për vend të lirë pune**

1 Vend vakant në Pozicionin “Drejtor Drejtorie” në Drejtorinë e Kujdesit për Pacientin dhe Pajisjet.

Kandidati për vendin vakant “Drejtor Drejtorie” duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit të dytë në Shkencat Ekonomike/Juridike/Inxhinierike/Shëndet Publik.
2. Të ketë të paktën 4 vjet eksperiencë pune në profesion.
3. Trajnimet, kualifikime apo dëshmi në fushën e profesionit përbëjnë avantazh.
4. Të ketë njohuri të paketës së Microsoft Office, përbën avantazh të njohë programe të tjera të profilit të tij/saj.
5. Të kete aftësi të mira të punës në grup dhe menaxheriale.

Kandidati i interesuar duhet të paraqesi këto dokumenta si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim, drejtuar Institucionit.
2. Curriculum Vitae (CV).
3. Diploma Universitare dhe Diploma Master, bashkëlidhur me çertifikatën e notave (kopje të noterizuara).
4. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit. (MASR)
5. Dëshmi e penalitetit.
6. Raport Mjekësor për aftësi në punë.
7. Fotokopje e kartës së identitetit.
8. Referenca nga punëdhënësi i mëparshëm.
9. Çertifikatë/Dëshmi për njohuritë e kompjuterit (kopje të noterizuara).
10. Çertifikatë/Dëshmi për kualifikime të kryera brenda apo jashtë shtetit, pjesëmarrje në konferenca, kongrese apo trajnime.
11. Librezën e punës, n.q.s ka (kopje e noterizuar) ose listën e kontributeve nga Portali E-albania.

Të interesuarit të paraqesin dokumentat, pranë Sektorit të Sekretari/Protokollit në Spitalin Universitar të Traumes nga data 16.04.2024-23.04.2024.